# AKT THEMELIMI
## I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
## " RUGA" Sh. P. K.

Në Tiranë më datë 16 Shkurt 2022, ne mbeshteteje te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", formohet Shoqeria tregetare me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **"Ruga" sh.p.k** me ortake themelues:

**Emanuele Grazioli** i biri i Alessandro dhe Maria Pia, i lindur në Rome më 29.10.1980 banues në Rome, Itali, Via Panama 79 00198, shtetas italian, i pajisur me Pasaporte me Nr. YA4845609.

**Diego Rocca** i biri i Angelo dhe Michele Crispino, lindur ne Genova me 28.02.1981, banues ne Itali, Via Watt 41,20143, Milano (MI) , shtetes italian, i pajisur me Pasaporte me Nr. YA6248866

### SELIA

**"Ruga" Sh. P. K** e ka seline e saj ne: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga George W. Bush, Ndërtesa Nr. 5, Kati 2, zyra 14. Shoqeria mund te hape filiale edhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

### KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise tregetare eshte pa afat.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

*Shoqëria ka për objekt zhvillimin e këtyre aktiviteteve me objekt si vijon:*

- Shërbimet call center, promovimi dhe marketingu telefonik outbound dhe inbound, promocione komerciale dhe reklamuese, aktivitete teleshitje për shitjen dhe promovimin e produkteve të ndryshme, aktivitete te customer satisfaction, phone collection, aktivitet te menaxhimin e numrave pa pagesë, pranimin dhe menaxhim te prenotimeve dhe porosive. Të gjitha me përjashtim të aktiviteteve të rezervuara me ligj.
- Realizim ose menaxhim i shërbimeve të call/ contact center në formën e tyre tradicionale ose në formën më të avancuar të multimedia business center multicanale me shumë kanale të bazuara në internet; realizim dhe menaxhimi i shërbimit ndaj klientit, kujdesi ndaj klientit, help desk, mailing, call back; zhvillimin dhe integrimin midis kanaleve të ndryshme të kontaktit: telefon, email, sms, web, etj.

- Shërbimi i ndërmjetësimit teknik për marrëdhëniet dhe asistencën teknike për dhe me klientët ose shërbimet e klientit për llogari të palëve të treta; call center e thirrjeve hyrëse (inbound), të cilat u përgjigjen thirrjeve të përdoruesit, duke përdorur për shembull numrat pa pagesë dhe sistemet e shpërndarjes automatike të thirrjeve, sistemet e integruara ndërmjet kompjuterit dhe telefonit me operatorin ose sistemet e përgjigjeve automatike me qëllim: marrja e porosive, anulimi, kërkesa për informacion mbi produktet dhe shërbimet e ofruara nga institucionet apo kompanitë; qendrat e thirrjeve dalëse (outbound), të cilat thërrasin përdoruesit, merren me aktivitete të shitjes dhe marketingut drejtuar klientëve.
- Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha veprimet industriale, tregtare, të pasurive të luajtshme e te paluajtshme që do të konsiderohen nga organi administrativ si të dobishme dhe të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, brenda kufijve të ligjeve në fuqi, dhe për rrjedhojë, vetëm si shembull, shoqëria mund të japë gjithashtu garanci reale dhe personale, dhe në favor të palëve të treta (me kusht që ato të jenë të lidhura me vetë shoqërinë nga marrëdhënie ekonomike dhe/ose aksionare)
- Marrja e shërbimeve ne fushën e telekomunikacionit;
- Krijim , menaxhim dhe tregtim i faqeve te internetit (web)
- organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve reklamuese dhe promovuese për çdo iniciativë tregtare kombëtare dhe ndërkombëtare, qoftë edhe si agjent. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha veprimet tregtare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Në çdo rast, nga qëllimi i shoqërisë përjashtohen veprimtaritë e rezervuara për ndërmjetësit financiarë dhe shoqëritë e brokerimit të pasurive të paluajtshme, ato të ndërmjetësimit, veprimtaritë profesionale të mbrojtura dhe në çdo rast të gjitha veprimtaritë e rezervuara me ligj për subjekte me kërkesa të veçanta që nuk zotërohen nga shoqëria.
- • Marrja e kontratave të agjencisë dhe përfaqësimit ndaj shoqërive vendase dhe të huaja që veprojnë në fushën e tregtimit të programeve kompjuterike, telefonisë dhe shërbimeve të telekomunikacionit në përgjithësi.
- Shërbimet e konsulencës dhe organizimit në sektorin e tregtisë elektronike nëpërmjet internetit dhe çdo forme tjetër komunikimi multimedial, me përjashtim të çdo veprimtarie të rezervuar me ligj për subjektet e regjistruara në regjistra të veçantë profesional.

*Ky aktivitet do të zhvillohet në fushën internacionale dhe në atë nacionale.*

Si objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për arritjen e objektivave te shoqërisë.

## KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise eshte 100.000 leke, kontribut i Ortakeve themelues ne perpjestime te shprehura ne Statut.

## ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise jane Asambleja e Ortakeve dhe Administrator te jete Z. **Diego Rocca**.

## NDARJA E FITIMEVE

Fitimet neto te Shoqerise qe rezultojne nga bilanci, pasi te zbriten shumat qe u perkasin detyrimeve ligjore, fondit rezerve dhe te tjera te percaktuara me ligj ose ne Statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve ndahen perpjestimisht sipas kontributit perkates te Ortakeve.

## MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin midis Ortakeve gjate zbatimit te ketij Akti Themelimi, ose midis Shoqerise dhe Ortakeve gjate aktivitetit te Shoqerise, duhet te zgjidhen me ane te biscdimeve. Ne rast te kundert palet i drejtohen Gjykates kompetente.

## TE TJERA

Dispozita me te hollesishme per funksionimin e Shoqerise, pershkruhen ne Statutin e saj qe eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne pese kopje te barazvlereshme dhe pasi u lexua u firmos rregullisht nga :

Ortaket e Shoqerise

**"Ruga"** *sh.p.k*

**Emanuele Grazioli**

EMANUELE GRAZIOLI

**Diego Rocca**

DIEGO ROCCA